

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenet 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA GLLOGOC

Për Aktivitetin e Prokurimit: 611-17-5030-2-2-1

Sa i përket tenderit për: "SIGURIMI FIZIK I TRI OBJEKTEVE - GJIMNAZIT "SKËNDERBEU", SHMP TË TEKNIKËS "TEHMI LLADROVCI" DHE OBJEKTIT TË KOMUNËS.

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK "ALPHA PRIVATE SECURITY" SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
PRISHTINË

(Adresa)
PRISHTINË

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

049 78 78 98

(Numri Telefonit)
ISLAM RAMAJ

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
alphasecur@yahoo.co.uk

(Adresa elektronike)

03.04.2018

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vulë)

KOMPANIJA SIGURIMIT
ALPHA PRIVATE SECURITY

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURIN.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 06.11.2017.
Pyetje drejtuar AK-së: 10.11.2017.
Përgjigjeje: 12.11.2017.
Pyetje drejtuar AK-së: 13.11.2017.
Përgjigjeje: 13.11.2017.
Hapja e ofertave: 27.11.2017.
Njoftimi për dhënie të kontratës: 11.12.2017.
Kërkesa për qasje në dokumentacion: 12.12.2017.
Qasja: 13.12.2017.
Me datë: 12.03.2018 njoftimi për tenderuesin e pasukëseshëm.
Njoftim për tenderuesin e pasukëseshëm: 27.03.2018.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Po kemi marrë pjesë nuk ka pasur vërejte.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtejshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☒

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët
Neni 64 Dëshmitë e kërkesave
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar

Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar dosjen e tenderit në E-prokurim, më pas ju kemi drejtuar disa pyetje lidhur me çmimin ku keni cekur

Pyetje:

Nëse keni mundësi të na sqaroni se në pagën neto prej 240.00 Euro a duhet të respektohet edhe Ligji i punës Nr. 03/L-212 ku të punsuarit përveq pagës bazë tatimeve, kontributeve pensionale duhet të paguhet edhe bazë të nenit 56.

Përgjigjje:

Ne do ta shpallim fitues OE i cili i plotëson kriteret administrative (i përgjegjshëm) dhe ofron qmim më të ulët për 24 muaj. Kontraktuesi me të cilin nënshkruajmë kontratë obligohet që për secilin objekt t'i angazhoj nga 4 punonjës të sigurimit fizik dhe që paga mujore për secilin të jetë: 240.00 €, NETO. Obligimet tjera ndaj shtetit (si TVSH-ja, Tatimi në Fitim, Kontributet, Tatimi në Paga, shitesat, ndalesat, pushimet vjetore, mjekësore etj)

janë përgjegjësi e OE.

Ne jemi në dijeni se janë në përgjegjësi të OE-ve por janë ligje që duhet zbatuar dhe është detyr e secilit OE të kalkuloj të gjitha këto në çmimë.

Të gjithë OE-të që kanë ofruar çmimë më të ulët se oferta jonë janë nën kriterin e kërkuar nga ana juaj dhe pagesen për punëtor në shumë prej: 240.00 €, NETO është e pa mundur ta realizojn.

Pasë qasjes në dokumente me datë:13.12.2017 ne kemi marr disa dokumente të OE-ve që kemi pas interes dhe kemi këto të gjetura se OE është i pa përgjegjshëm.

Provë procesverbal i datës:13.12.2017

Lidhur me çmimin e ofruar nga OE-të ne kemi bërë një analiz dhe del se:

nr.	ANALIZA FINANCIARE "ALPHA PRIVATE SECURITY" SH.P.K.	
1	PAGA NETO	240.00
2	TATIMI NE PAG	6.67
3	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNETORIT	12.98
4	PAGA BRUTO	259.65
5	KONTRIBUTI PENSIONAL I PUNEDHENSIT	12.98
6	PAGA TOTALE PER NJE PUNËTORË PA TVSH	272.63
7	TVSH-ja	49.07
8	PAGA TOTALE PËR NJË PUNËTORË ME TVSH	321.71
9	12 PUNËTOR X 321.71 PAGA TOTALE = 3,860.48 EURO	3,860.48
10	3,860.48 EURO PER MUAJ X 24 MUAJ= 92,651.43	92,651.43
11	FITIMI I KOMPANIS	32.73
12	VLERA TOTAL E OFERTES	92,684.16

Cmimi per mbulimin e pagave te 12 punëtrve te sigurimit ,tatimit ne pag, kontributit pensional te punëtorit, kontributit pensional te punedhensit dhe tvsh-së pragu duhet te jet 92,651.43 per 24 muaj si ne tabelen me lart ku kolona nr 1 deri ne 10 tregon ne detaje si eshte ardhur deri te pragu, qe do te thot qdo kompani e cila eshte nen ket qmim nuk l plotson kushtet, qe l bie se kompania fituse "SFK" sh.p.k. do te punoj me humbje ne vler -14,337.03. Kompania "SFK" sh.p.k. nuk ka te llogaritur tatimit ne pag, kontributit pensional te punëtorit 5%, kontributit pensional te punedhensit 5% dhe nje pjes te tvsh-së. prandaj kerkoj qe lenda te shkoj ne rivlersim.

Provë lista e kontratave dhe kopjet e kontratave të prezantuara.

Po ashtu lidhur me nënshkrimin dhe plotësimin e formularit të dosjes së tenderit OE i rekomanduar për kontratë del se personi që ka nënshkruar nuk është pjesë e pronësisë apo person i autorizuar në informata të certifikates së biznesit, dhe nuk ka prezantuar autorizim në dosje. Provë ANEKS 2 dhe dokumentet e kompanisë.

Për arsye se edhe OE "Rosa Security" është në listë më të lirë me çmim se kompania në kemi analizuar edhe dokumentacionin e kësaj OE-je dhe kemi gjetur se dhe ky OE është i papërgjegjshëm si në aspektin administrativ ashtu dhe në atë financiar.

OE në fjalë

OE ka ofruar një listë të kontratave ku ka cekur se është për 3 vitet e por që të gjitha kontratat janë për vitet 2015,2016 që do të thotë se kërkesën tuaj për 3 vitet e fundit nuk e ka plotësuar.

Provë raporti i vlersimit i përpluar nga ana juaj me datë:09.03.2018.

Presim që kërkesa jonë të aporovohet dhe të kthehet në rivlersim të shpallëmi si OE me çmimin më të lirë të përgjegjshëm.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Koha humbur,stresi shkaktuar dhe mundësia e nënshkrimit të kontrates.

9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*